



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/161
Datë: 25.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 34, paragrafi 12. të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 17 paragrafi 3. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M


1. Emërohet Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Farmaceutikës, Grupi Nr. 47 në këtë përbërje:
 - 1.1. Zade Kuqi, Zyrtare e Lartë për Politikën dhe Përshkrimin dhe Klasifikimin të Vendeve të Punës, në DMZP/MPB, kryesuese;
 - 1.2. Merita Vuthaj, Udhëheqëse e Divizionit për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës, anëtare;
 - 1.3. Jahë Gecaj, Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore/MSH, anëtar;
 - 1.4. Ibadete Mehmeti, Udhëheqëse e Divizionit për Zhvillimin e Politikave Reformuese dhe Mbikëqyrje, anëtare;
 - 1.5. Teuta Islami - Hetemi, Universiteti i Prishtinës "Fakulteti i Shkencave Matematike, Natyrore", anëtare.

Përbërja e anëtareve zëvendësues të Komisionit

- 1.1. Leonora Zeka, Zyrtar e Lartë e Politika të Organizimit Funkcional në DMZP/MPB;
 - 1.2. Servete Shuleta, Shefe e Divizionit për Planifikimin e Menaxhimit të Rrezikut - Departamenti i Farmakologjisë/AKPPMK;
 - 1.3. Nadire Lleshi, Udhëheqëse e Divizionit për Produkte Medicinale me emra të mbrojtur dhe Gjenerik, Departamenti i Autorizimit për Marketing/AKPPM;
 - 1.4. Bedri Zyberaj, Drejtor i Departamentit të OJQ-ve/MPB;
 - 1.5. Lindita Aliaga, Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" .
2. Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Farmaceutikës, Grupi Nr. 47 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi ka një mandat dy (2) vjeçar.
3. Anëtari nga pika 1.5 e këtij Vendimi ka të drejtën e kompensimit sipas nenit 20, paragrafit 1 dhe 2. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
4. Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Farmaceutikës, Grupi Nr. 47 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/161
Datë: 25.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 34, paragrafi 12. të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, neni 17 paragrafi 3. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M


1. Emërohet Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Shëndetit/Mjekësisë, Grupi Nr. 18 në këtë përbërje:
 - 1.1. Minire Gjokaj, Zyrtare për Administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Informatave të Burimeve Njerëzore, në DMZP/MPB, kryesuese;
 - 1.2. Arsim Qavdarbasha, Drejtor i Departamentit për Shërbime Shëndetësore/MSh, anëtar;
 - 1.3. Laura Shehu, Udhëheqëse e Divizionit për Shëndet Mendor/ AKPPM, anëtare;
 - 1.4. Ibadete Mehmeti, Udhëheqëse e Divizionit për Zhvillimin e Politikave Reformuese dhe Mbikëqyrje, anëtare;
 - 1.5. Kreshnike Dedushaj, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës/ShSKUK, anëtare.

Përbërja e anëtareve zëvendësues të Komisionit:

- 1.1. Shqipe Abdullahu, Zyrtare për Politika të Pagave, Divizioni i Politikave të Pagave dhe Zhvillimit të Strukturave Funktionale në DMZP/MPB;
 - 1.2. Merita Vuthaj, Udhëheqëse e divizionit për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës;
 - 1.3. Jahë Gecaj, Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzorë/MSh;
 - 1.4. Bedri Zyberaj, Drejtor i Departamentit të OJQ-ve/MPB;
 - 1.5. Ganimete Uka, QKMF " Dr. Hafir Shala " Drenas.
2. Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i shëndetit/mjekësisë, Grupi Nr. 18 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi ka një mandat dy (2) vjeçar.
3. Anëtari nga pika 1.5 e këtij Vendimi ka të drejtën e kompensimit sipas nenit 20, paragrafit 1. dhe 2. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
4. Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Shëndetit/Mjekësisë, Grupi Nr. 18 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/161
Datë: 25.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 15, paragrafi 3. të Ligjit Nr. 08/L-0193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213, Vendimin e Qeverisë Nr. 29/112 i datës 13.12.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 03/128 të datës 16.02.2023, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M


1. Aprovohet ndarja dhe transferimi i mjeteve buxhetore në vlerë prej 10,000,000.00 € (dhjetë milionë euro) për Zbatim të Masave të Eficiencës së Energjisë për Shtëpitë Individuale të Banimit.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën-programi "Kontigjenca për Energji" me kod 29050, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe transferohen në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencioneve dhe Transfereve".
3. Mjetet e ndara sipas këtij Vendimi transferohen tek organizata jo-buxhetore Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, në llogarinë bankare të përcaktuar nga ta, për zbatim të Thirrjes Publike të Zbatimit të Masave të Eficiencës së Energjisë për Shtëpitë Individuale të Banimit.
4. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00097) në programin përkatës.
5. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

A r s y e t i m

Me qëllim të mbështetjes financiare të projektit emergjent "Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë për Shtëpitë Individuale të Banimit" dhe në përkrahje të thirrjes publike të shpallur nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë për zbatimin e Projektit të apostrofuar, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete buxhetore në vlerë prej 10,000,000.00 € (dhjetë milionë euro).

Përmes mbështetjes buxhetore dhe implementimit të Projektit "Zbatimi i Masave të Efiçencës së Energjisë për Shtëpitë Individuale të Banimit" synohet përmirësimi i kursimit të energjisë dhe rritjes së mirëqenies në shtëpitë individuale. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë